

1. REALIZIMI I MISIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

Misioni i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “ Wisdom University ” e cila nisi veprimtarinë në vitin akademik 2008-2009, është përgatitja e individëve të kualifikuar, të formojë nje klasë drejtuese, moderne e të lirë, që do të mundesojë Shqipërinë dinjitoze në familjen europiane, në formësimin e një komuniteti të drejtë dhe rezultativ.

Misioni i sipërpërmendur është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, të shprehur në nenin 2 të ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me standardet ndërkombëtare, Kartën e Bolonjës, si dhe me veçantitë dhe risitë që synon të sjellë ky institucion në vendin tonë dhe më gjerë.

Për të përmbushur misionin dhe rolin që institucionet e arsimit të lartë, në tërësinë e tyre kanë në dobi të shoqërisë, ku zhvillojnë aktivitetin e tyre, Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “ Wisdom University ” gjatë vitit akademik 2015-2016, kreu aktivitete të shumëllojshme në fushën e mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe kontributin e saj për shoqërinë.

Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” është licensuar fillimisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 672, datë 27.9.2006, në emër të shoqërisë “Wisdom” sh.p.k. për të ofruar studimin në distancë, i cili do të realizohej nëpërmjet bashkëpunimit me Universitetin “S PioV” të Romës. Sipas asaj marrëveshjeje, ofrohej mundësi studimi në programet: 1. Shkenca bankare dhe të sigurimeve; 2. Shkenca politike. Ky institucion do të ofronte studime universitare të ciklit të parë, të cilat do të zgjasnin 3 (tre) vite akademike. Në mbarim të studimeve ShLUJ “Wisdom University” do të jepte diplomë universitare “Bachelor” në titujt: 1. Shkenca bankare dhe të sigurimeve; 2. Shkenca politike. Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” do të fillonte veprimtarinë në vitin akademik 2006-2007. Pas licensimit, nga ana e shoqërisë “Wisdom” sh.p.k. u morën të gjitha masat për sigurimin e të gjithë ambienteve dhe mjeteve të tjera të nevojshme, duke përfshirë rekrutimin e stafit akademik dhe administrativ, si dhe hartimin e të gjithë kurrikulave, programeve të lëndëve dhe instalimin e teknologjisë së nevojshme. Gjithësesi, në atë kohë në Shqipëri mungonte infrastruktura e nevojshme teknologjike e komunikimit broadband, për pasojë zhvillimi i kurseve në distance bëhej efektivisht i pamundur. Rrjedhimisht, shoqëria Wisdom sh.p.k., bazuar në planet afatgjata të zhvillimit kërkoi dhe u licensua me VKM, Nr.

254, datë 27.2.2008, për hapjen e fakultetit me programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, për: 1. Psikologji; 2. Drejtësi. Kohëzgjatja e këtyre programeve do të jetë 3 vjet. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer.

Menjëherë pas licencimit, ShLUJ “Wisdom University” arriti të rekrutojë me sukses stafin e nevojshëm akademik, të sigurojë infrastrukturën dhe lehtësirat e tjera të nevojshme, si dhe të fillojë aktivitetin në vitin akademik 2008-2009. Kurrikulat dhe programet e lëndëve janë hartuar nga specialistët më të njohur në vend, në bashkëpunim me specialistë të huaj në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit në fuqi në RSh, me Deklaratën e Bolonjës, me standardet më të mira të tjera ndërkombëtare, sipas treguesve të përcaktuar nga Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). Po ashtu, një ndër objektivet e tjera kryesore të ShLUJ “Wisdom University” është respektimi, mbrojtja dhe promovimi i parimeve dhe rregullave të etikës së kërkimit shkencor, lirisë akademike dhe i autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me Deklaratën e Limës mbi Lirinë Akademike dhe Autominë e Institucioneve të Arsimit të Lartë të vitit 1988, si dhe Deklaratën Dar es Salaam mbi Lirinë Akademike dhe Përgjegjësinë Shoqërore të Akademikëve të vitit 1990. Vlen të theksohet se Shoqëria “Wisdom” sh.p.k. zotëron licencat dhe ushtron aktivitet prej vitesh në fushën e arsimit të mesëm dhe në atë të aftësimin profesional nëpërmjet organizimit të kurseve të gjuhëve të huaja.

Programet Bachelor në Drejtësi dhe në Psikologji janë akredituar me sukses mbi bazën e vendimit Nr. 150, datë 18.02.2011 të Këshillit të Akreditimit të APAAL. me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 188, datë 25.04.2011.

Me Vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 128, datë 03.12.2010 dhe me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 241, datë 31.05.2011, janë miratuar që të hapen programet e studimit në:

1)

- a. Master i Shkencave në “E Drejta Civile dhe Tregtare;

- b. Master i Shkencave në “E Drejta Penale”;
- c. Master i Shkencave në “E Drejta Publike dhe Administrative”.

2)

- a. Bachelor në “Menaxhim-Biznes”;
- b. Bachelor në “Marketing Komunikim”;
- c. Bachelor në “Financë-Bankë”.

Pas akreditimit të programeve “Bachelor” në Drejtësi dhe Psikologji, si dhe licensimit të programeve Master i Shkencave, në përputhje me kërkesat ligjore, por edhe me rrethanat e reja të krijuara, nga ana e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" është bërë riorganizimi i plotë organizativ i institucionit. Ky riorganizim është miratuar nga Këshilli i Akreditimit me vendimin Nr. 214, datë 29.07.2011 dhe me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 412, datë 25.08.2011.

Sipas këtij organizimi, SHLU "Wisdom University" përbëhet nga:

1. Fakulteti i Drejtësisë me njësitë bazë:

- 1.1 Departamenti i të Drejtës Publike
- 1.2 Departamenti i të Drejtës Private
- 1.3 Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore me njësitë bazë:

2.1 Departamenti i Psikologjisë

2.2 Departamenti i Ekonomisë

2.3 Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Gjatë vitit akademik 2015-2016 u realizuan disa objektiva të Projekt - Planit të Njesisë Kërkimore dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Arritja më e rëndësishme në kontekstin shkencor ishte botimi i revistës periodike shkencore, Botim i `Wisdom University` Nr. 2, Prill 2016. Kjo revistë shkencore ka bordin e saj editorial, i cili përbëhet nga profesorë të disa fushave studimore, si drejtësi, ekonomik, shkenca sociale dhe të gjuhës së huaj, etj. Në këtë botim u publikuan artikuj shkencorë të pedagogëve të ShLUJ `Wisdom University`.

U organizua Seminari i hapur me teme “Rritja e cilesise dhe sigurise ne jeten e qytetarit lidhur me sherbimet ekonomike, juridike dhe psikologjike”.

Moren pjese studente te SHLUJ `Wisdom University`, te Fakultetit te Drejtesise dhe te Fakultetit te Shkencave Ekonomike dhe Shoqerore, ku u zhvilluan diskutime rreth prezantimeve te paraqitura prej studenteve te perzgjedhur si referuesit me te mire te fakulteteve perkatese. Seminari u zhvillua ne kuader te aktiviteve te programuara nga Qendra Studentore me qellim potencializimin e studentit per rritjen e cilesise se tij akademike, por edhe si nje vlere e shtuar per institucionin tone.

ShLUJ `Wisdom University` në bashkëpunim me Institutin për Kërkim dhe Zhvillim `Wisdom` dhe Institutin European për Menaxhim, Drejtësi dhe Diplomaci të Shkupit, Maqedoni, organizoi më datë 25 Maj, 2016, Konferencën Ndërkombëtare me temë: “*Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”. Kjo konferencë pati vlera të rëndësishme për nga përfaqësia e institucioneve

të larta shtetërore në vend si : Gjykata e Krimeve të Rënda, Prokuroria e Krimeve të Rënda, Agjensia e Administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, Akademia e Sigurisë, etj. Gjithashtu, morën pjesë në konferencë Shoqata e Avokatëve Penalistë dhe “Kolegji AAB”, Prishtinë. .

"Instituti për Kërkim dhe Zhvillim WISDOM" (IKZHW) në bashkëpunim me Agjencinë e Kërkimit Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) , datë 16 Maj 2016 , në ambientet e SHLUJ “ WISDOM University” organizoi Ditën Informative “INFO DAY” mbi Programet Evropiane të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, që financojnë dhe mbështesin Kërkimin Shkencor nga KE.

Në datën 11 Maj 2016 në SHLUJ “ Wisdom University” u organizua event i prezantimit të organizatës “European Legal” që ka si qëllim rritjen profesionale, dhe integrimin e juristeve nga vendet e Ballkanit Perëndimor në një fazë të hershme të harmonizimit të legjislacioneve me Eu Acquis. Ky event u organizua në bashkëpunim me “Klinikën Ligjore Wisdom”

U organizua konferenca Shkencore me temë "Roli i Psikologjisë në Kontekstin Shoqëror", organizuar nga ShLUJ "Wisdom University" -Departamenti i Psikologjisë.

U organizua Konferenca Shkencore : “Aktualiteti Ekonomik në Shqipëri dhe Progresi për Integrim në Bashkimin Europian” - organizuar nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore në mjediset e ShLUJ "Wisdom University", më 15 Prill 2016.

Institucioni ka bërë hapa të dukshëm në konsolidimin e tij, në sigurimin e cilësisë dhe ofrimin e një modeli ndryshe dhe bashkëkohor për studimet e larta në Shqipëri, duke u përshtatur vazhdimisht me ndryshimet ligjore të ndodhura, sfidat e vendit dhe sidomos sfidat e integritimit evropian të vendit, zhvillimet në tregun e punës, ndryshimet në marrëdhëniet shoqërore, ekonomike dhe politike etj. Shkolla e Lartë Universitare “Wisdom University ” ka realizuar misionin e arsimit të lartë :

- Duke përgatitur specialistë në fushën e shkencave juridike (juristë) me formim të përgjithshëm në “Bachelor” dhe shkencor “Master i Shkencave” në i) E Drejtë Penale dhe ii) E Drejtë Civile dhe Tregtare .
- Duke përgatitur specialistë në fushën e psikologjisë në Bachelor dhe Master sipas

sistemit të Bolonjës.

- Duke përgatitur specialistë në fushën e Menaxhim Biznesit dhe Finance Banke me formim të përgjithshëm në Bachelor sipas sistemit të Bolonjës.
- Duke kryer studime dhe kërkime në fushën e shkencave juridike, ekonomike dhe të psikologjisë.

2. REALIZIMI VJETOR I OBJEKTIVAVE TË INSTITUCIONIT

Gjatë vitit akademik 2015-2016, SHLUJ “Wisdom University ”përmbushi synimet e planifikuara, në lidhje me procesin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit ndaj shoqërisë.

Gjithashtu, SHLUJ“Wisdom University ”përfundoi procesin e akreditimit institucional . Pas një pune të gjatë, të nisur më parë, Urdher nr. 237 datë 09.05.2016 të MAS, SHLUJ“Wisdom University “ mori akreditimin institucional. Gjithashtu me Urdher nr.236 datë 09.05.2016 te MAS mori akreditimin të programeve të studimit Master i Shkencave në “E drejtë Civile dhe Tregtare” dhe Master i Shkencave në“ E Drejtë Penale”. Me Urdher nr.289 dt 30.05.2016 SHLUJ“Wisdom University “ mori akreditimin e programit te studimit Bachelor ne “ Menaxhim Biznesi”. U licensua programi i studimit `Master i Shkencave ne “ Psikologji Shkollore dhe Edukimi” me Urdher nr. 192 dt. 22. 04.2016 te MAS.

Objektivat kryesore të institucionit kanë synuar:

- Sigurimin i cilësisë më të lartë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- Kultivimin dhe zhvillimin e etikës së kërkimit shkencor;
- Zhvillimin dhe përshtatjen e kurrikulave të programeve mësimore me nevojat dhe perspektivat e zhvillimit të vendit;
- Zbatimin e metodave të avancuara e bashkëkohore të mësimdhënies, ndër të tjera nëpërmjet nxitjes së të mësuarit interaktiv, duke përdorur teknika, materiale dhe përvoja të universiteteve të zhvilluara perëndimore;
- Nxitjen e zhvillimit të një metodologjie ndryshe të mësimdhënies, jashtë skemave klasike të zbatuara deri më tani në Shqipëri, nëpërmjet mbajtjes së disa leksioneve nga profesorë të huaj, si dhe shfrytëzimit të një literature të bollshme në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera të huaja;
- Zbatimin e kriterëve më të larta të mësimdhënies dhe mësimnxënies për stafin akademik dhe për studentët;
- Ndalimin e çdo lloj praktike të keqe, përfshirë praktikatat diskriminuese.
- Zbatimin e metodave transparente të vlerësimit të stafit dhe të studentëve dhe nxitjen e zhvillimit të tyre nëpërmjet skemave të ndryshme të shpërblimit.
- Hartimin e programeve të lëndëve në mënyrë të atillë që të plotësojnë nevojat e studentëve,

të shmangët mbivendosja midis tyre, si dhe të përcaktohen qartë, objektivat, metodologjia, literatura, etj;

- Caktimin e objektivave të qarta për çdo program studimi, se çfarë duhet të dijë dhe çfarë do të jetë në gjendje të bëjë pas përfundimit të programit.
- Caktimin e treguesve të qartë për vlerësimin e studentëve;
- Vendosjen e një lidhje të mirë dhe funksionale me komunitetin në përgjithësi dhe veçanërisht me gjyqësorin, administratën shtetërore dhe komunitetin e biznesit, me qëllim praktikimin e dijeve të studentëve dhe promovimin e tyre në tregun e punës;
- Promovimin i arritjeve në të mësuar me pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme studentore, kërkimore dhe shkencore;
- Zbatimin e një politike të vazhdueshme të nxitjes së të mësuarit tek studentët;

Mësimdhënia në këtë institucion ka synuar jo vetëm zbatimin me sukses të metodave bashkëkohore, por është edhe produkt i kombinimit të disa lloje metodash duke filluar nga ato klasike deri tek ato ndër-aktive dhe që simulojnë situata praktike të moderuara nga profesori përkatës ose të zhvilluara në autonomi të plotë nga studentët. Përdorimi i mjeteve audiovizuale gjithashtu ka qenë një risi për institucionin tonë në rang kombëtar, po t'i referohemi fillimit të zbatimit të teknologjisë më të lartë të mundshme në nivel evropian të videokonferencës që në fillimet e veta etj. Një karakteristikë tjetër është edhe kombinimi i stafit akademik vendas me profesorë të huaj dhe profesorë vizitorë. Ky kombinim ka bërë të mundur që studentët të mund të përfitojnë nga modelet dhe metodat e ndryshme që ato sjellin, por edhe të mund të jenë në gjendje të marrin njohuri të cilat dalin jashtë kontekstit të vendit tonë dhe që u mundësojnë një këndvështrim të ndryshëm për çështjet objekt studimi. Po ashtu, një ndër objektivat kryesore ka qenë dhe mbetet shndërrimi i këtij institucioni në një qendër të kërkimit shkencor, i cili ka një karakter të posacëm ose ndërdisiplinor dhe që orientohet sipas sfidave me të cilat përballët vendi ynë dhe faktorët e tjerë socialë, ekonomikë dhe politik në funksion të gjetjeve të zgjidhjeve dhe propozimit të zgjidhjeve si mjete për hartimin e politikave, si dhe në funksion të forcimit të dijeve në doktrinat përkatëse shqiptare. Institucioni ka synuar dhe ka bërë çmos që kërkimi shkencor të jetë përcjellës i mendimit shkencor shqiptar dhe ky mendim të ndërkombëtarizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së stafit në aktivitete shkencore, realizimit të

botimeve ndërkombëtare e kombëtare, si dhe organizimit të aktiviteteve shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare që tashmë janë bërë pjesë thelbësore e aktivitetit tonë.

Godina në të cilën SHLUJ“Wisdom University ” zhvillon aktivitetin mësimor, përmban të gjithë infrastrukturën e nevojshme fizike dhe teknologjike për një zhvillim të procesit mësimor, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare dhe në të njëjtën kohë duke mundësuar veçanërisht mbështetjen e vazhdueshme të procesit të mësimdhënies në përdorimin e teknologjisë së informacionit. Klasat janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme, si smart board, kompjuter, projektorë, mundësi kondicionimi, ndriçim natyral i mjaftueshëm, si dhe mjediset e tjera (salla e konferencës, biblioteka) etj, të cilat ndihmojnë në zhvillimin maksimal për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.

Për sa i përket procesit të kërkimit shkencor, SHLUJ“Wisdom University ” vlerëson mbështetjen e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë. Për këtë qëllim, bazuar në rregulloren për promovimin e publikimit dhe të kërkimit shkencor, SHLUJ“Wisdom University ” mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit. Në këtë kuadër, gjatë vitit akademik 2015-2016 u publikuan artikuj nga stafi akademik si dhe u organizua një konferencë ndërkombëtare nga ana e këtij institucioni. Në kuadër të objektivave kërkimore, në muajin Maj 2015, institucioni ynë është angazhuar të mbështesë parimet e Kartës dhe Kodit të Euraxess nga Komisioni Evropian, duke nënshkruar Deklaratën e Angazhimit dhe në Qershor, 2015. Institucionit tonë i`u komunikua se do të listohet në faqen e zyrtare të Kartës dhe Kodit.

Për sa i përket zbatimit të masave të parashikuara në planin strategjik afatshkurtër, gjatë vitit akademik 2015-2016 u siguroa realizimi i masave të mëposhtme:

- Përfundimi i procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të ciklit të dytë;
- Akreditimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi
- Botimi i revistës periodike shkencore, Botim i `Wisdom University`, Nr. 2, Prill, 2015
- Nënshkrimi i Marreveshjes të bashkepunimit në datën 16.06.2016 ndërmjet Shoqërisë Wisdom Sh.p.k dhe Institutit European për Menaxhim Drejtësi dhe Diplomaci, Shkup.

-Nënshkrimi i Memorandumit te Bashkepunimit ndermjet ShLUJ” Wisdom University” dhe Tirana Bussiness University

- Mbështetja e procesit të mësimdhënës në rezultatet e nxënies;

- Rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit nga ana e stafit dhe e studentëve;
- Përthithja e stafit akademik me përvojë dhe me tituj akademikë, duke mundësuar mbulimin mbi 75% të mësimdhënies nga stafi me kohë të plotë;
- Organizimi i konferencës dhe aktiviteteve shkencore të organizuara nga ana e shkollës;
- Shtimi cilësor dhe sasior i publikimeve shkencore të stafit të shkollës;
- Rritja e kapaciteteve të bibliotekës;
- Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së studentëve të pranuar në shkollë;
- Rritja e bashkëpunimit me universitetet dhe institucionet kërkimore-shkencore, brenda dhe jashtë vendit;
- Përbushja e detyrave të tjera të parashikuara në planin e lartpërmendur.

3 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI INSTITUCIONIN

3.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE TITULLARI I INSTITUCIONIT

LIDA

3.2 ORGANET VENDIMMARRËSE, SI DHE NJËSITË AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE, SHOQËRUAR ME TITULLARËT PËRKATËS

Autoritetet drejtuese

Rektor: Prof.Asc.Dr.Shefqet Muci

Zv. Rektor: Dr.Naim Mecalla

Kancelari: Msc.Alban Deda



Dekan i Fakultetit të Drejtësisë: Prof.Asc.Dr.Kosta Gazeli

Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore:

PhD. Edvana Tiri

Senati Akademik

• Prof.Asc.Dr.Shefqet Muci	Kryetar
• Dr.Naim Mecalla	Anetar
• Prof.Asc.Dr.Kosta Gazeli	Anetar
• Anetar	
• Dr.Elmaz Sherifi	Anetar
• Dr.Iljaz Mehmeti	Anetar
• Dr.Zihni Goxhaj	Anetar
• Dr.Edo Sherifi	Anetar
• Dr.Alma Shehu	Anetar
• Msc. Fatmira Laska	Anetar
• Ma.Valbona Softa	Anetar
• (Student)	Anetar
• (Student)	Anetar



. Njësitë Administrative dhe ndihmese

- Sekretaria mësimore – 4 punonjese

-Kabineti I Rektorit/Kurrikula -1 punonjes

- Zyra e burimeve njerëzore -1 punonjes

- Zyra e financës – 2 punonjes

Sanitare -2 punonjes

Shofer -1 punonjes

Ndihmes -1 punonjes

Total 12 punonjes

3.3 PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA NGA ANA E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JO PUBLIKE “ WISDOM UNIVERSITY ” SI DHE PROGRAMET E STUDIMIT NË PROCES LICENCIMI

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.2.2008 “Për licencimin e Shkollës së Lartë Jopublike “Wisdom University ” dhe me urdhrat e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës nr.254 datë 27.02.2008 dhe nr.241 datë 31.05.2011 janë hapur këto programe studimi me kohë të plotë në:

Ciklit i parë:

Bachelor në

1. Drejtësi; Urdher nr.254 datë 27.02.2008
2. Psikologji Urdher nr.254 datë 27.02.2008
3. Menaxhim Biznesi Urdher nr.241 datë 31.05.2011
4. Financë –bankë ; Urdher nr.241 datë 31.05.20

Cikli i dytë:

5. *Master i shkencave në “ E drejtë Civile dhe Tregtare” Urdher nr.241 datë 31.05.2011*
6. *Master i shkencave në “ E drejtë Penale” ” Urdher nr.241 datë 31.05.2011*
7. *Master i shkencave në “ Psikologji Shkollore dhe Edukimi” Urdher nr. 192 dt. 22. 04.2016 te MAS*

3.4 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME NUMERIKE MBI INSTITUCIONIN:

1. Nivelet dhe programet e studimit që ofron institucioni

a) Fakulteti i Drejtësisë ofron:

Programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Bachelor:

1. Drejtësi (3 vite akademike);

Programet e studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Master i Shkencave :

1. E drejtë civile dhe Tregtare (2 vite akademike);
2. E drejtë Penale (2 vite akademike);

b) Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore ofron:

Programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimeve me kohë të plotë, në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Bachelor ne :

1. Psilologji (3 vite akademike);
2. Menaxhim Biznesi (3 vite akademike).
3. Financë – Bankë (3 vite akademike).

Programet e studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë Master i Shkencave :

- Psikologji Shkollore dhe Edukimi (2 vite akademike);

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar sipas niveleve dhe programeve të studimit;

Programi Bachelor 2015-2016	Numri i studentëve	Programi Master i Shkencave 2015-2016	Numri i studentëve
“Drejtesi”	109	“ E drejte Penale”	54
“Psikologji”	39	“ E drejte Civile “	52
“Menaxhim Biznesi	21		
Gjithsej	169	Gjithsej	106
Gjithsej numri i studentëve të rregjistruar në Programet e ciklit të parë Bachelor dhe Ciklit te Dyte “ Master i Shkencave “= 275			

Numri i të diplomuarve sipas niveleve dhe programit të studimit;

Programi Bachelor 2015-2016	Numri i të diplomuarve	Programi Master i Shkencave 2015-2016	Numri i të diplomuarve
“ Drejtesi”	61	“ E drejte Penale”	10
“ Psikologji”	35	“ E drejte Civile dhe Tregtare “	13
Gjithsej	96	Gjithsej	23
Totali i të diplomuarve në Programet e ciklit të pare dhe të dytë = 119			

Numri i studentëve të transferuar (shoqëruar me informacion mbi institucionin e parë, programin e studimit dhe semestrin ku transferohet);

VITI AKADEMIK 2015-2016						
Transferime	Bachelor në Drejtësi	Bachelor në Menaxhim Biznesi	Bachelor në Finance	Bachelor ne Psikologji	Master i Shkencave “ E drejte Penale”	Master i Shkencave “ E drejte Civile dhe Tregtare “
Ndërmjet Universiteteve	42	12	1	17	0	12
Gjithsej Transferime Bachelor			72			
Gjithsej Transferime Master			12			
Gjithsej Total			84			

Pagesat totale (tarifat e studimit, regjistrimit etj.) për secilin program studimi në bazë të kohëzgjatjes së studimit;

Tarifat e studimit për vitin akademik 2015-2016 ishin si më poshtë:

NR	CIKLI I STUDIMEVE	EMËRTIMI I PROGRAMIT	TARIFA E STUDIMIT
1	Bachelor	Drejtësi	1350 €
2	Bachelor	Psikologji	1350 €
3	Bachelor	Menaxhim Biznesi	1350 €
4	Bachelor	Financë Banke	1350 €
5	Master i Shkencave	E drejtë Civile dhe Tregtare	1500€
6	Master i Shkencave	E drejtë Penale	1500€

Numri i përgjithshëm i personelit akademik (të listuar së bashku me të dhënat mbi numrin e Prof., Dr., etj. dhe raportet studentë/profesorë).

Lista e stafit akademik për vitin akademik 2015-2016

Gjatë vitit akademik 2015-2016 në SHLUJ“ Wisdom University ” janë angazhuar pedagogë 48 (kohe te plote dhe të pjesshme) për 463 studentë. Raporti student-pedagog është 1 me 9 duke mundësuar punën intensive me studentët për të mbështetur e monitoruar nga afër rritjen e tyre cilësore e profesionale vit pas viti.

Politika e SHLUJ“ Wisdom University ” në këtë drejtim është të tërheqë staf të kualifikuar kryesisht me grada e tituj shkencorë, standard i përcaktuar në strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Stafi akademik 2015 – 2016

Lida

Stafi akademik i Fakultetit të Drejtësisë me kohë të plotë

Departamenti	Prof. Dr.	Prof. Asoc	Dr.	Doktorant	Master	Gjithsej
E drejtë Pulike		1	2	1	3	7
E drejtë Private	1	1	1	2	2	7
Kërkimi Shkencor			3	3	1	7
Gjithsej	1	2	6	6	6	21

Stafi akademik i Fakultetit të Drejtësisë me kohë të pjesshme

Departamenti	Prof. Dr.	Prof. Asoc	Dr.	Doktorant	Master	Gjithsej
E drejtë Pulike	0	0	0	0	0	0
E drejtë Private	0	0	1	0	1	2
Kërkimi Shkencor	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	0	0	1		1	2

Stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore me kohë të plotë

Departamenti	Prof. Dr.	Prof. Asoc	Dr.	Doktorant	Master	Gjithsej
Ekonomisë	0	2	1	2	2	7
Psikologjisë	0	1	2	1	3	7
Kërkimi Shkencor	0	1	2	1	3	7
Gjithsej	0	4	5	4	8	21

Stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore me kohë të pjesshme.

Departamenti	Prof. Dr.	Prof. Asoc	Dr.	Doktorant	Master	Gjithsej
Ekonomisë	0	0	2	0	1	3
Psikologjisë	0	0	1	0	0	1

Kërkimi	0	0	0	0	0	0
Shkencor						
Gjithsej	0	0	3	0	1	4

Stafi akademik 2014 – 2015

Titulli	Kohe të plotë	Kohe të pjesshme	Gjithsej
Prof. Dr.	1	0	1
Prof. Asoc	6	0	6
Dr.		4	15
Doktorant	10	0	10
Master	14	2	16
Gjithsej	42	6	48

4. RELACION NË LIDHJE ME PLOTËSIMIN E STANDARDEVE SHTETËRORE

4.1 PËRSHTATSHMËRIA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME MISIONIN E INSTITUCIONIT

Siç u përmend edhe më lart, Misioni i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “ Wisdom University ” është përgatitja e individëve të kualifikuar, të formojë një klasë drejtuese,

moderne e të lirë, që do të mundësojë Shqipërine dinjitoze në familjen europiane, në formësimin e një komuniteti të drejtë dhe rezultativ.

Në këtë kuadër, të gjitha programet e studimit kanë marrë si bazë për përcaktimin e objektivave të tyre misionin dhe vizionin e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “ Wisdom University ”. Të gjitha programet e studimit të të gjitha niveleve të ofruara nga ana e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “ Wisdom University ” synojnë të përgatisin njerëz të aftë e të kualifikuar që t’i shërbejnë sa më mirë shoqërisë dhe nevojave të saj, jo vetëm në planin kombëtar, por edhe në atë global.

Institucioni ynë, në kuadër të organizmit të kurrikulave në përputhje me zhvillimet më të fundit në universitetet më të mirënjohura në botë, në përputhje me tendencat e zhvillimit politik, ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe në harmoni me zhvillimet në tregun e punës, ka hartuar kurrikulat mësimore, të cilat synojnë një profilizim të studentit në fushën e studimit përkatëse, duke i krijuar mundësi atij të thellohet në fusha të caktuara. Po ashtu, një rëndësi të veçantë i është kushtuar edhe aftësimit praktik të studentëve duke parashikuar në kurrikula praktika profesionale me zgjatje të gjithpranuar nga ligji dhe nga praktika botërore, si dhe për çdo lëndë, përsa kohë është mundshme, parashikohet kryerja e disa detyrave me karakter praktik në mënyrë të pavarur dhe nën mbikëqyrjen e pedagogut.

a. REALIZIMI I SYNIMEVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT NGA ANA PËRMBAJTJESORE

Programet e studimit të Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “ Wisdom University ” janë në përputhje me misionin dhe vizionin e Shkollës së Lartë. Një nga synimet kryesore të përbashkëta të programeve të studimit është përgatitja e intelektualëve të rinj, me dije të mjaftueshme dhe të gatshëm për të kontribuar në përballimin e nevojave të shoqërisë, nëpërmjet një kurrikule bashkëkohore dhe në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Institucioni ka synuar gjithmonë dhe arritjet e deritanishme kanë provuar që ka pasur si objektiv kryesor shndërrimin e tij në një institucion të arsimit të lartë, i cili do të ishte modeli i

një institucioni relativisht të vogël, por me një vizion bashkëkohor për zhvillimin e tij. Ky vizion ka konsistuar kryesisht në ndërtimin dhe zbatimin e planeve mësimore që dalin jashtë skemave klasike dhe që adresojnë sic duhet jo vetëm kërkesat e tregut të punës, por edhe sfidat me të cilat përballet vendi, perspektivat e zhvillimit ekonomik, social dhe politik, globalizimin e hapësirës së arsimit të lartë, ekonomisë etj, shmangien maksimale të mbivendosjeve të tematikave në programet e lëndëve si brenda një cikli ashtu edhe nga një cikël në tjetrin, pasjen si politikë bazë zhvillimore kultivimin e kërkimit shkencor dhe forcimin e karakterit aplikativ të tij në fushat e shkencave shoqërore etj.

b. PERSHTATSHMERIA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME ZHVILLIMET E FUNDIT EKONOMIKE NË VEND DHE ME TREGUN E PUNËS, OSE ME ZHVILLIMET E FUNDIT KULTURORE NË FUSHAT E ARTIT.

Programet e studimit të ofruara nga ana e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University ” janë në përputhje të plotë qoftë me kërkesat aktuale të tregut të punës, ashtu edhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim, e cila synon integrimin në tregun unik evropian.

Institucioni ka bërë hapa të dukshëm në konsolidimin e tij, në sigurimin e cilësisë dhe ofrimin e një modeli ndryshe dhe bashkëkohor për studimet e larta në Shqipëri, duke u përshtatur vazhdimisht me ndryshimet ligjore të ndodhura, sfidat e vendit dhe sidomos sfidat e integritit evropian të vendit, zhvillimet në tregun e punës, ndryshimet në marrëdhëniet shoqërore, ekonomike dhe politike etj. Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University ” ka realizuar misionin e arsimit të lartë :

- Duke përgatitur specialistë në fushën e shkencave juridike (juristë) me formim të përgjithshëm në “Bachelor” dhe shkencor “Master i Shkencave” në i) E Drejtë Penale dhe ii) E Drejtë Civile dhe Tregtare .
- Duke përgatitur specialistë në fushën e psikologjisë në Bachelor dhe Master sipas

sistemit të Bolonjës.

- Duke përgatitur specialistë në fushën e Menaxhim Biznesit me formim të përgjithshëm në Bachelor sipas sistemit të Bolonjës.
- Duke kryer studime dhe kërkime në fushën e shkencave juridike, ekonomike dhe të psikologjisë.

c. REALIZIMI I SYNIMEVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT NËPËRMJET MBULIMIT ME PERSONELIN AKADEMIK TË PËRSHTATSHËM

Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “ Wisdom University ” ka siguruar një staf të mirëkualifikuar për një mësimdhënie cilësore, në përputhje me standardet më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kështu në vitin akademik 2015-2016 janë angazhuar në procesin mësimdhënës 48 pedagogë, prej të cilëve 1 me titullin akademik “Profesor”, 6 me titullin akademik “Profesor i Asocuar”, 15 me gradën shkencore “Doktor”, 10 “Doktorant” dhe 16 me titullin “Master”.

Vlerësimi mesatar për të gjithë pedagogët dhe lëndët

Një ndër mënyrat që institucioni ka zbatuar për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë është përdorimi i pyetësorëve të cilët realizohen me studentët tonë me bazë vjetore ose semestrale.

Vlerësimi i punës pedagogeve bëhet nga Dekanati dhe Rektori. Në vijim, në shërbim të rritjes së cilësisë, institucioni ynë po bën përpjekje të vazhdueshme për të adoptuar politika dhe strategji të reja në lidhje me kriteret e cilësisë, rritjen e mëtejshme të standardeve ekzistuese në kuadër të hapësirës mbarë evropiane të Arsimit të Lartë. Funkcionet e NjsBC (Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë) tashmë shihen nga ana e institucionit tonë si një pjesë

integrale e menaxhimit të procesit didaktik, por gjithashtu edhe si një instrument për rritjen e performancës në institucionin tonë. Në vazhdimsinë e zbatimit të reformave për standartet evropiane të Arsimit të Lartë, funksioni i NjSBC është zhvilluar duke marrë një pozicion të ri në funksion të rritjes së vazhdueshme të cilësisë.

NjSBC, pas riorganizimit të saj, beri planin e punës për vitin akademik 2015-2016, ka ndarë detyrat duke organizuar punën për përmbushjen e tyre. NjSBC vepron si një strukturë me veprimtari të pavarur, për të ofruar siguri objektive dhe këshillim, për të shtuar vlerën duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e veprimtarive mësimore. NjSBC ndihmon menaxhimin didaktik dhe jo vetëm, duke ofruar analiza, rekomandime, këshillime dhe informacione lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar.

Vlerat që karakterizojnë veprimtarinë e NjSBC janë :

- *Integriteti*, që do të thotë ndershmëri, objektivitet, aftësi, shmangie e konfliktit të intëresave në ushtrimin e veprimtarisë.
- *Pavarësia dhe Objektiviteti*, që do të thotë pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë dhe dhënie e opinioneve e gjykimeve objektive.
- *Profesionalizmi*, që do të thotë zbatim i standardeve profesionale me kujdesin e duhur profesional dhe korrektësi, mbështetur në metodologjitë dhe praktikat më të mira, si ato të universiteteve perëndimore.
- *Komunikim dhe Informim*, që do të thotë komunikim korrekt, objektiv, të qartë, konciz dhe konstruktiv gjatë veprimtarisë së tij.

Më poshtë rendisim disa nga realizimet e planit të veprimtarisë së NjSBC.

- NjSBC organizoi takime me stafin akademik dhe gjatë diskutimeve u pa nevoja e krijimit të një *Pyetësori për Pedagogët*. Qëllimi i tij konsiston në ndihmën që i jepet institucionit për të kuptuar më mirë nëpërmjet përgjigjeve pikpamjet që ka stafi akademik për institucionin në tërësi. Pyetësori është anonim, gjë që lejon shprehjen e mendimit të lirë nga ana e pedagogëve.

- Gjithashtu, duke studiuar të gjitha materialet dhe të dhënat e SHLUJ “Wisdom University” dhe duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet e ekspertëve të jashtëm, u vlerësua që të bëheshin ndryshime në pyetësonin ekzistues për studentët. Ky pyetëson u përditësua jo vetëm me pyetje për pedagogët, por edhe për çështje të tjera, si lidhur me leksionet, komunikimin student-pedagog, infrastrukturën mësimore etj. Gjatë pyetësorit u pa e nevojshme të kërkoheshin dhe mendime e sugjerime të tjera eventuale, që ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë .
- NjsBC, në një lirshmëri të plotë, me qëllim përshtatjen ndaj produktit dhe misionit të institucionit, gjatë muajit nëntor 2015 hartoi kalendarin e kontrollit të brëndëshëm të cilësisë për programet mësimore të semestrit të parë dhe të dytë për vitin akademik 2015-2016. Në bashkëpunim me departamentet dhe në përputhje me lirinë dhe autonominë akademike, është asistuar në seminarët dhe leksionet për lëndët përkatëse sipas një kalendarit të paracaktuar nga vetë Njësia. Janë mbajtur relacionet përkatëse dhe në fund të muajit Mars u përgatit një relacion përmbljedhës për pikat e dobëta dhe të forta të çdo pedagogu, ndihma e ndërsjellët, shkëmbimi i përvojave ndërmjet pedagogëve për metodologjinë e mësimdhënies si dhe plotësimi nga studentët i pyetësorit me rubrika të ndryshme në lidhje me mësimdhënien / mësimnxënien për pedagogët, të cilat i kanë shërbyer sigurimit të cilësisë.
- Janë vërejtur angazhime serioze nga lektorët në orët e leksioneve, ku ka mbizotëruar një nivel i lartë i kompetencës mësimore dhe profesionalizmit nga pedagogu për zhvillimin e lëndës, si dhe është konstatuar një formë moderatore e bashkëpunimit me studentët në orët e seminareve. Pedagogët kanë asistuar në sigurimin e cilësisë së orës së mësimit me anë të mjeteve bashkëkohore të mësimin, duke përdorur teknologjinë e avancuar Video Projektor Poëer Point, Dvd, Cd-Roms, alternuar këto me eksperiencën e vlefshme dhe të dukshme të pedagogëve në shpjegimin e koncepteve teorikë dhe punimeve praktike në auditorë si dhe formën tradicionale të punës me libra dhe materiale shtesë (revista dhe artikuj shkencorë, cikle ushtrimesh, botime kërkimore bashkëkohore, etj.). Nuk ka pasur raste të mungesës së profesionalizmit në ushtrimin e detyrës së pedagogut. Në fund të kontrolleve për të gjitha lëndët e semestrit, është organizuar një takim i përbashkët me stafin e departamentit përkatës, ku janë ballafaquar përvojat e secilit në shërbim të

përmirësimin të cilësisë.

Realizimi i anës përmbajtjesore kërkon dhe vlerësimin e duhur të performancës së studentëve. Për këtë arsye, është adoptuar formula që siguron një zhvillim dialektik të performancës së studentit, si dhe rritje të cilësisë së bashkëveprimit student – pedagog. Performanca e studentëve vëzhgohet përmes vënies në funksionim të një mekanizmi monitorues. Ky mekanizëm, që në vetvete përbën edhe një gjetje apo tregues të cilësisë, mbështetet mbi pesë kolona apo elementë që konsistojnë në:

- Vijueshmërinë e tyre në leksione, pjesëmarrjen dhe angazhimin në zhvillimin e debatit dhe të shkëmbimit të opinioneve në grupe gjatë orëve të seminarit,
- Nivelin cilësor të angazhimit të tyre në procesin e debatit dhe shkëmbimit praktik të opinioneve gjatë zhvillimit të orëve të seminareve, përmes ballafaqimit të kazuseve të importuara nga praktika gjyqësore, administrative si dhe psikologjike.
- Detyrën e Kursit, e cila përbën domethënien akademike të studentit. Përmes organizimit dhe shpërndarjes së disa tematikave në grupe të veçanta është siguruar reagimi i studentëve për tema të përbashkëta, duke rritur ndjeshëm edhe shanset e identifikimit të nivelit të cilësisë së tyre në lidhje me shprehjen dhe kohezionin e dijeve dhe të dhënave të tyre akademike.
- Kolokiumin, i cili përfaqëson arritjen e studentit në nivel semestral. Në hartimin e tezave në këtë “ballafaqim student-pedagog” i është kushtuar vëmendje e veçantë arritjes së vlerës praktike të këtyre tezave. Mënyra e testimit gojor ose me shkrim e studentëve ka krijuar një avantazh të padiskutueshëm si për studentin, i cili ka pasur në posedim hapësirën e nevojshme shprehëse të dijeve të tij, ashtu dhe për pedagogun që ka ushtruar në mënyrë të ndërsjellët një kontroll më të gjerë dhe më efikas mbi përgatitjen e studentit,
- Testin përfundimtar, që realizohet me anën e provimit të përgjithshëm apo të punimit për mbrojtjen e diplomës.

Gjithashtu, nga ana e NjSBC u organizuan kontrole për zbatimin e planeve kalendar dhe respektimin e tyre gjatë semestrit të parë dhe të dytë, si:

Kërkimet për gjetjen dhe evoluimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë, të cilat janë fokusuar në veçanti në përdorimin e mësimit bashkëkohor, të mësuarit dhe vlerësimin e studentëve, me qëllim promovimin e një qasje interaktive me studentin në qendër.

Përgatitjet dhe organizimet e pyetësorëve për mësimitin e mësimitin, për vlerësimin e studentëve dhe në përgjithësi për procesin mësimor.

Vlerësimi në mënyrë periodike i efikasitetit të veprimtarive mësimore, kërkimore shkencore, kulturore, si dhe të veprimtarive administrative të SHLUJ “Wisdom University”, në mënyrë më të hollësishme:

- vlerësimi i programeve të reja mësimore;
- riorganizimi i Zyrës së Kurrikulave për monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin efikas të programeve të lëndëve dhe në vazhdimësi;
- zgjedhja, emërimi, vlerësimi dhe zhvillimi profesional i stafit akademik;
- vlerësimi i efektivitetit të mekanizmave dhe procedurave të sigurimit të cilësisë;
- hartimi dhe informimi i vazhdueshëm i studentëve nëpërmjet Guidës së studentëve për institucionin dhe kurrikulën në tërësi.

Element i rëndësishëm i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është vlerësuar edhe ndihma e ndërsjellët ndërmjet pedagogëve për metodologjinë e mësimitin, si dhe kontrolli, në përputhje me parimet e lirisë akademike, të seminareve, të leksioneve, të detyrave të kursit dhe të praktikës mësimore, duke ofruar alternative për zgjidhjen e problemeve.

Institucioni ynë tashme ka një sistem të konsoliduar të Cilësisë, por megjithatë janë marrë masa për ta bërë këtë sistem sa më efikas, për arritjen e standarteve të cilësisë të procesit mësimor, kryesisht cilësisë e mësimdhënies.

1. Pyetësi për studentët, duke marrë në konsideratë syzgjimet e ekspertëve të jashtëm dhe të dhënat që kishte SHLUJ “Wisdom University”, u vlersua që të bëheshin ndryshime dhe në pyetësin për studentën. Pyetësit u përditësuan jo vetëm me pyetje për pedagogët por dhe në lidhje me leksionet, komunikimi student-pedagog, infrastrukturën mësimore si dhe u kërkua nga ana e studentit opinione në tëresi mbi kurset e ofruara. Relacioni analitik për rezultatet e pyetësorit bëhet brenda muajit shkurt.

2. *Pyetësi për Pedagogët*, NjSBC organizoi takime me stafin akademik, dhe gjatë diskutimeve u pa nevoja e krijimit të një pyetësi për pedagogët. Qëllimi i të cilit konsiston në ndihmën që i jepet institucionit për të kuptuar më mirë nëpërmjet përgjigjeve pikpamjet që ka stafi akademik për institucionin në tëresi, procesin mësimor, mendime për përmirësimin e metodologjisë, etj.. Pyetësi është anonim, gjë që lejon shprehjen e mendimit të lirë nga ana e pedagogëve.

3. Kalendari i kontrollit të brendëshëm të cilësisë, NjSBC, në një lirishtëri të plotë, me qëllim përshtatjen ndaj produktit dhe misionit të institucionit, gjatë muajit Nëntor hartojë kalendarin e kontrollit të brendëshëm të cilësisë për programet mësimore të semestrit të parë për vitin akademik 2015-2016. Në bashkëpunim me departamentet dhe në përputhje me lirinë dhe autonominë akademike, është asistuar në seminarët dhe leksionet për lëndët përkatëse sipas një kalendari të paracaktuar nga vetë Njësia. I fokusuar kryesisht në anën formale, orari, plani kalendar, sylabusi...Është mbajtur relacion lidhur me problemet e konstatuara, të cilat më pas janë trajtuar në formë bashkëbisedimi me pedagogun mësimdhënës. Në fund të semestrit të parë bëhet një relacion përmbledhës për pikat e dobëta dhe të forta të çdo pedagogu, ndihma e

ndërsjellët, shkëmbimi i përvojave ndërmjet pedagogëve për metodologjinë e mësimdhënies. Relacioni përmbledhës do të bëhet brenda muajit Mars.

4. Relacioni për realizimin e programeve të lendeve dhe plotësimi nga çdo pedagog i raportit semestral, ku ndërmjet të tjerave pasqyrohen përmbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës (syllabusit), pjesëmarrja, kalueshmëria, nota mesatare, mendime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit mësimor për të ardhmen., etj.

Janë vërejtur angazhime serioze nga lektorët në orët e leksioneve, ku ka mbizotëruar një nivel i lartë i kompetencës mësimore dhe profesionalizmit nga pedagogu për zhvillimin e lëndës, si dhe është konstatuar një formë moderatore e bashkëpunimit me studentët në orët e seminareve. Pedagogët kanë asistuar në sigurimin e cilësisë së orës së mësimin me anë të mjeteve bashkëkohore të mësimin, duke përdorur teknologjinë e avancuar Video Projektor PowerPoint, Dvd, Cd-Roms, alternuar këto me eksperiencën e vlefshme dhe të dukshme të pedagogëve në shpjegimin e koncepteve teorikë dhe punimeve praktike në auditorë si dhe formën tradicionale të punës me libra dhe materiale shtesë (revista dhe artikuj shkencorë, cikle ushtrimesh, botime kërkimore bashkëkohore) ofruar nga biblioteka e ShLUJ “WisdomUniversity”. Nuk ka pasur raste të mungesës së profesionalizmit në ushtrimin e detyrës së pedagogut. Në fund të kontroleve për të gjitha lëndët e semestrit, është organizuar një takim i përbashkët me stafin e departamentit përkatës, ku janë ballafaquar përvojat e secilit në shërbim të përmirësimit të cilësisë.

Në përfundim të realizimit të këtyre detyrave, janë hartuar nga NJSBC relacione, informacione përmbledhese ku do të identifikohen problemet dhe pikat e dobëta, pas përfundimeve të relacioneve analitike do të sugjerohen masa dhe propozime për përmirësimin e punës dhe rritjen e standartit të cilësisë së procesit mësimor. Do të organizohen nga ana e fakulteteve trajnime me pedagogët e rinj për metodologjinë e mësimdhënies dhe për probleme të tjera që do të shërbejnë rritjes së cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies, në funksion të rritjes së cilësisë së procesit mësimor.

Në kuadrin e sigurimit të cilësisë së brendshme, në auditore u zhvillua pyetëtori i studentëve një javë para përfundimit të semestrit të parë dhe semestrit të dytë.

Gjatë zhvillimit të procesit të anketimit mënyra e menaxhimit të pyetësorëve ishte transparente dhe përzgjedhja e studentëve ishte e rastësishme. U respektua një kohë e përshtatshme në një ditë normale mësimi për kryerjen e anketimit, ku studentët plotësuan me vullnet të lirë dhe të plotë rubrikat e pyetësorëve.

Nga analiza e përgjithshme e përgjigjeve të mara prej pyetësorit u vërejtë se në përgjithësi për të gjitha degët dhe vitet marrëdhënia institucion-student është e mirë, studenti ndihet mirë si me anën infrastrukturore ashtu edhe me atë didaktike dhe akademike. Nuk ka pakënaqësi në lidhje me gjithë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, po ashtu ka një përputhshmëri midis pritshmërive me të cilat studenti aksesojë në institucion dhe asaj se çfarë institucioni ofron në realitet për të mbuluar të gjitha shërbimet e tij akademike dhe jo vetëm.

Për sa i përket fushës së pakënaqësive të shfaqura prej studentit u vu re se këta të fundit nuk kishin sugjerime të shprehura në lidhje me asnjë prej procesve të ofruara prej ShLUJ “Wisdom University”.

Në përgjithësi studentët janë të kënaqur me atë që ju ofrojnë kurset e studimit, me mjetet e nevojshme për ushtrimet praktike (dokumentacioni, pajisjet informatike, instrumentat, mjete laboratorike, etj.) pasi që ato janë të disponueshme dhe në masën e duhur, me atë që ju ofrohet për sa i përket institucioneve/qendrave/strukturave ku zhvillohet praktika profesionale (stazh, punë laboratorike, ushtrime, projekte, etj. Po ashtu ata shfaqën në përgjithësi të kënaqur me përshtatshmërinë e sallave në të cilat zhvillohet mësimi (ka vënde, shikohet, dëgjohet, etj).

Në përgjithësi leksionet në secilin prej kurseve kanë rezultuar të qarta të bazuar në një formim shkencor të kënaqshëm dhe profesional duke i bërë programet e këtyre kurseve interesante dhe tërheqëse për studentin, duke stimuluar edhe pjesëmarrjen aktive të studentëve nga pedagogët e lëndës dhe sigurisht duke rritur komunikimin midis vetë studentit dhe pedagogut.

Punësimi i të diplomuarve dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës

Zyra e Këshillimit të Karrierës vepron dhe funksionon në bazë të nenit 45 të Statutit të ShLUJ “Wisdom University”, dhe ka si objekt të punës së saj mundësimin e këshillave dhe ndihmës për studentët në lidhje me karrierën e tyre. Veprimtaria e saj vjen në zbatim të Rregullores së Brëndëshme ku specikohen në nenin 4 dhe 5 të saj objektivat dhe fusha e veprimit të kësaj zyre.

Misioni i kësaj njësie bazë është të ndihmojë në punësimin e studentëve dhe të diplomuarve të ShLUJ “Wisdom University”, të ofrojë shërbimet më të mira për studentët, stafin dhe grupet e tjerë të interesit në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e edukimit dhe t’i ndihmojnë ata të zhvillojnë potencialin e plotë dhe të kenë një performancë sa më të lartë në tregun e punës. Mbi këtë bazë janë përcaktuar edhe fushat kryesore të veprimit të kësaj stukture brënda ShLUJ “Wisdom University” e cila do të ndihmojë studentët në orientimin drejt tregut të punës nëpërmjet këshillimit të karrierës si dhe rritjen e numrit të studentëve e të diplomuarve që punësohen në profesionin e tyre. Kjo do të shërbejë edhe si një mundësi e mirë rekrutimi për shumë organizata dhe institucione dhe të ofrojë shërbime trajnimi për biznese të ndryshme. Këshillimi i karrierës ofron mundësinë për të provuar punën e dëshiruar nëpërmjet praktikave të punës, mundësinë dhe aftësinë e ndërtimit të një rrjeti njohjesh në ambientet profesionale të tregut të punës, gjithashtu përgatit propozimet për ndryshime dhe përmirësime të kurrikulave duke ia paraqitur për miratim strukturave përkatëse. Për të përmbushur misionin zyra e karrierës ka përcaktuar në planin e saj edhe zhvillimin e ditëve të karrierës një mënyrë informimi kjo që ndihmon studentin me atë se çfarë është karriera, si ta menaxhojmë atë dhe si të aftësohemi në maksimum për tu afruar me tregun e punës duke njohur më së mirë aftësitë individuale.

Shluj “Wisdom University” ka bashkëpunuar me organizata të ndryshme si Coco-Cola Bottling Shqipëria, CBS Sh.P.K, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Z. Luigi Verardo, Hotel Diplomat, përfaqësuar nga Z. Florenc Skendaj. Në bisedime me shoqërinë Eurosig Albania dhe Road Signs&Marking RSM, Shoqata e Avokatëve Penalistë dhe Studio Ligjore Vishaj, për të angazhuar praktikantët si dhe për të gjeneruar vlera për këto organizata, për një

kohë afatgjatë. Bashkëpunimi është bërë në formën e memorandumit të mirëkuptimit në lidhje me:

- bashkëpunimin për kurrikulat,
- bashkëpunim nëpërmjet seminareve të përbashkëta,
- të konferencave të përbashkëta ,
- iniciativa të bamirësisë etj.

Takimet në këto organizata janë bërë me drejtuesit e burimeve njerëzore dhe ata që kanë ndikim në procesin e punësimit dhe vendimarrjes me qëllimin që të caktojë një udhëheqës/ tutor për ndjekjen dhe vlerësimin e performancës së praktikantit.

Edhe nga ana e institucionit tonë për praktikantin caktohet një udhëheqës akademik i cili e ndihmon studentin për :

- Krijimin e një portofoli të menaxhimit të karrierës
- Përgatitjen e tij për intervistë
- Komunikimin me organizatën pritëse,
- Për të qënë kontakti i parë më të në lidhje me problemet ose çështjet serioze
- Si dhe vlerësimin e tij në përfundim të praktikës së tij.

Pasi institucioni ynë merr kontaktet me organizatën pritëse për dërgimin studentëve praktikantë, fton studentët të aplikojnë në vendet e identifikuara në lidhje me mundësitë që kanë dëshirë të jepen. Kjo për arsye se shumë kompani vlerësojnë interesin e kandidatëve potencialë më shumë se aftësitë e tyre aktuale. Më pas merret një vendim mbi kriteret e përzgjedhjes dhe dërgojmë studentët për intervistë pas ardhjes së kërkesës nga kompania. Në fund i komunikohet studentit vendimi i marrë mbi pozicionin e praktikës profesionale, dhe detyrimi që ai ka për përgatitjen e një raporti në përfundim të praktikës.

Aktivitetet që organizon SHLUJ “Wisdom University” për zgjerimin e lidhjeve me tregun e punës janë :

- Panairet e karrierës
- Ditët e karrierës
- Prezantimet e kompanive në kampus
- Punësim në ambjentet e kampusit
- Seminare dhe tryeza të rrumbullakta të përbashkëta
- Përfshirja e studentëve në iniciativa bamirësie
- Punë projekti të përgatitura dhe të zbatuara nga studentët, etj,

Në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Karrierës po edhe me të gjithë njësitë e tjera të institucionit tonë është edhe *Qendra Për Jetën Studentore*, e cila funksionon në bazë të nenit 19 të Rregullores së SHLUJ “ Wisdom University”, e krijuar me qëllim të mbështesë vetorganizimin e studentëve në unione, organizata dhe qeveri studentore, që të nxisë pjesmarrjen e studentëve në mirëdrejtimin e SHLUJ “Wisdom University”, për të ndërgjegjësuar studentët për rolin vendimtar që ata kanë në ndërtimin e karrierës së tyre si dhe për të dëgjuar nga afër zërin dhe mendimin e tyre. Studentët duhet të informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe institucioni në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës, me Përgjegjësin e Qendrës Studentore dhe me Zyrën e Kurrikulave ka mundur edhe një Guidë Studenti për vitin akademik që është duke u zhvilluar, e aksesueshme prej studentëve në bibliotekën e shkollës por edhe online. Aty tregohet në mënyrë të hollësishme si të orientohemi në universitet, kush na vjen në ndihmë, cilët janë lëndët dhe personeli akademik dhe çdo informacion tjetër që i nevojitet studentit për tu përshtatur me jetën studentore. Udhëzuesi mbi orientimin e studentit ka për qëllim të ofrojë një kornizë të përgjithshme mbi shërbimet kryesore të ofruara nga ShLUJ “ Wisdom University”, në mënyrë që të shoqërojë studentin e ardhshëm në rrugën e zgjedhjes për sa i përket identifikimit të fushës së vet disiplinore, për sa i përket mbajtjes së kontakteve të vazhdueshme me institucionin në plotësim të kërkesave për marrjen e informacioneve të ndryshme në interes të tij si dhe në lidhje me hapat që duhet të ndërmerren për tu regjistruar dhe zgjedhur kurset e studimit.

Orientimi zhvillohet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës e cila organizon dhe promovon aktivitete të fokusuara tek studenti kryesisht të atyre që janë në vitin e fundit të studimit, për të

këshilluar studentët, për të ndërrmarë një zgjedhje të vetëdijëshme dhe për të furnizuar profesorët referent me aftësinë informative për çdo njësi Universitare në mënyrë që të bashkëshoqërojnë zgjedhjet e studentëve të tyre.

Në veçanti aktivitetet orientuese finalizohen në:

- Suportim i studentit në kërkimin e informacionit të nevojshëm në mbështetje të zgjedhjeve që studentit do të ndërrmarë.
- potencializimin e aftësive mbi vetëorientimin
- Stimulim nga ana e studentit për vetëvlerësimin në krahasim me përgatitjen vetjake disiplinare dhe të aftësive transversale.

Ndërmjet iniciativave të propozuara sinjalizojmë për:

Ditët e orientimit:

Pesë ditët e orientimit i janë dedikuar prezantimit të ofertave akademike dhe të disa prej shërbimeve drejtuar studentit. Këto ditë të parashikuara për orientimin e studentëve janë të shtrira në fillim të tetorit për çdo vit akademik dhe parashikojnë një start informativ për çdo strukturë didaktike të universitetit në tërësi si dhe një kalendar prezantimi në auditore të kurseve të studimit të zhvilluara nën kujdesin e pedagogëve të programeve dhe departamenteve përkatëse. I gjithë prezantimi mbi orientimin e studentit mund të gjehet edhe online në sitin e ShLUJ “Wisdom Universitetit” info@Wisdom.al

“Universiteti” me dyer të hapura:

Takime mes studentëve dhe docentëve, zhvillimi i leksioneve dhe i vizitave të drejtuara me kah drejt strukturave universitare. Kjo vjen e realizuar në dy sesione, një që i përket semestrit të dimrit dhe një që i përket sezonit të verës, përkatësisht semestrit të parë dhe të dytë të vitit akademik, sipas departamenteve dhe fakulteteve. Këto janë rastet që studentët të njihen me të

drejta të plota me mënyrën e funksionimit dhe me realitetin akademik të ShLUIJ. “ Wisdom University”.

 *Orientime:*

Projekte që kanë të bëjnë me platforma që vënë në qendër të tyre njohjen e studentit online dhe në departamentet përkatëse me programet e studimit ku për secilin kurs janë në dispozicion: informacion në bazë të kursit (leksione, oraret, planet mësimore), një pjesë orientuese (mënyrat e të sjellurit, rregulloret , i forumeve apo i takimeve me tutoriatet përkatëse për t`u këshilluar apo për të shprehur shqetësime dhe pikpyetje të ndryshme në lidhje më proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Për të potencializuar këtë shërbim, pra atë të Qendrës Studentore, janë nxitur studentët që të organizohen në Qeveri Studentore ose më saktë në Senat Studentor. U zhvillua një garë e hapur dhe e drejtë midis studentëve të interesuar të cilët shpalosën idetë e tyre se si mund të rrisin pjesëmarrjen e studentit në ndihmë të mirëfunksionimit të institucionit , u zgjodhën senatorët sipas grupeve dhe fakulteteve si dhe kryetari i këtij senati. Po ashtu po në mbështetje të studentit janë organizuar seminare të hapura si ai me Dhomën Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë me qëllim rekrutimin e studentëve për trajnime të ndryshme në fushën e biznesit në kompani gjermane, po ashtu edhe arritjen e marrëveshjeve të ndryshme me studio ligjore si Studio Ligjore Vishaj apo me kompani tëë ndryshme prestigjoze si Coca-cola Bottling Shqipëria të cilat ndihmojnë me praktika profesionale studentët tanë para diplomimit të tyre. Gjithashtu në ndihmë të orëve individuale të studentit janë parashikuar nga Qendra edhe nxitja e vetorganizimit të studentëve në Klube Studentore. Klubet Studentore kanë në plan të parë orientimin e studentit, akomodimin e tij me jetën studentore dhe zbulimin e saj, pasi një elitë e mirëfilltë përgatitet vetëm atëherë kur përkrah një mësimdhënieje cilësore ofrohet një atmosferë mikpritëse jetese në komunitet. Organizimet e studentëve janë një element kyç për jetën studentore dhe krijimin e bashkëveprimit pozitiv në kampus. Organizatat e studentëve janë një mjet i shkëlqyer për të shprehur interesat e përbashkëta.

Në ShLUIJ “Wisdom University” funksionojnë në bazë të vetorganizimit këto klube:

- Klubi Ligj dhe Demokraci
- Klubi I Sipërmarrjes studentore
- Klubi jeta Studentore
- Klubi vullnetarët në Shoqëri
- Klubi Sportiv.

Në mbështetje të tyre institucioni ynë është përpjekur gjithmonë që tu vijë në ndihmë studentëve duke i ndjekuar ata në mënyrë të vazhdueshme, ndihmon unionet e tyre duke i pajisur me mjetet e nevojshme që disponon, parashikon edhe buxhetet e nevojshme për shpenzimet që kanë organizimet studentore duke u kujdesur që ky buxhet ti shërbejë me efikasitet larmishmërisë së aktiviteteve studentore.

Përfshirja e studentëve në përmirësimin e programeve, procesit të mësimdhënies dhe përfaqësimi i tyre në strukturat qeverisëse të IAL

Përfshirja e studentëve në përmirësimin e programeve të lëndëve mundësohet në radhë të parë nëpërmjet pyetësorit të përvitshëm të tyre lidhur me stafin akademik dhe procesin e mësimdhënies, në përmbajtje të të cilit është kërkuar mendimi i studentëve lidhur me qartësinë e objektivave të lëndës, kuptueshmërinë e leksioneve apo tekstit të rekomanduar, përshtatshmërinë e prezantimit të lëndës, aspektet pozitive dhe negative të lëndës si dhe sugjerime lidhur me përmirësimin e mundshëm të saj. Për këtë qëllim, në ShLUJ “Wisdom University”, janë zhvilluar dy pyetësorë “Për Vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies” gjatë semestrit të parë dhe të dytë, i cili u ndërtua me pyetje që kërkonin informacion nga të anketuarit, studentët, lidhur me vlerësimin e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies, përvetësimin e aftësive praktike të studentit gjatë mësimnxënjes, ngritjen e nivelit të të nxënësve profesional dhe të sigurimit teknik të materialeve të nevojshëm. Kjo përfshirje mundësohet edhe me kontaktet e vazhdueshme me pedagogët, të cilët janë njëkohësisht edhe këshilltarë akademikë. Prezantimit të zërit të studentëve për procesin e mësimdhënies i shërbejnë edhe zgjedhja me votë të fshehtë e senatorëve në çdo grup dhe përfaqësimi i tyre me studentët më të mirë në Këshillin Shkencor, në Senat dhe në organet e tjera vendimmarrëse.

Qeveria Studentore, e zgjedhur në mënyrë demokratike nga vetë studentët çdo vit, është organi që përfaqëson interesat e studentëve. Pjesëmarrja e studentëve në qeverisjen e ShLUJ “Wisdom University” është realizuar nëpërmjet përfshirjes së përfaqësuesve të tyre në strukturat drejtuese.

Përfaqësuesit e Qeverisë Studentore janë:

Fakulteti i Drejtësisë, Cikli i Parë Bachelor:

Viti I – Alban Sulollari

Viti II- Sonila Grami

Viti III- Edmond Dalipi

Fakulteti Skencave Ekonomike dhe Shoqërore, Cikli i Parë Bachelor, programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi:

Viti I- Sara Mero

Viti II- Klevi Rama

Viti III- Xhuljana Zogu

Fakulteti Skencave Kkonomike dhe Shoqërore, Cikli i Parë Bachelor, programi i studimit Bachelor në Psikologji:

Viti I- Enxhi Muça

Viti II- Ilda Sula

Viti III- Leme Meta

Fakulteti i Drejtësisë, Master i Shkencave – Nancy Tushe

4.2 INFORMACION NË FORMË TABELORE MBI BASHKËPUNIMET NDËRINSTITUCIONALE DHE PROJEKTET KU MERR PJESË INSTITUCIONI

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2015-2016, SHLUJ “Wisdom University”, u vizitua nga profesori dhe njëkohësisht gjygtari, Dale A. Craëford, SHBA, në kontekstin e marërveshjes `Visiting Professorship` të nënshkruar me CILS, (Qendra Ndërkombëtare për Studime Ligjore) Salzburg, Austri, për të zhvilluar leksione të gjuhës angleze për qëllime specifike, në fushën e së drejtës penale.

Ne Muajin Shkurt u aplikua për Modulin Jean Monnet ” Empowering and strengthening the knowledge in EU business affair”. Qëllimi i modulit është që të nxitet kërkimi dhe analiza kritike në fushën e BE dhe zhvillimit rajonal midis studentëve, kërkuesve dhe lektorëve dhe të zhvillohet kërkimi në fushën e zhvillimit rajonal dhe BE.

Themeluesi Shoqeria “Wisdom” shpk, ka krijuar Fondacionin **“Instituti për kërkim dhe zhvillim Wisdom”**, e cila është një organizate jo qeveritare jofitimprurese që e bazon veprimtarinë e saj në parimin e respektimit, mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të njeriut, të parashikuara në Kushtetutën e Republikës të Shqipërisë, ligjet dhe marreveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.

“Instituti për kërkim dhe zhvillim Wisdom” në kuadrin e thirrjes për aplikim me projekte kërkimore e shkencore në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT) për 7 fushat e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit për vitin 2015 – 2016, publikuar nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) datë 16 Tetor 2015, ka aplikuar me projekt idenë të titulluar: Smart parking

“Instituti për kërkim dhe zhvillim Wisdom” ka aplikuar në thirrjen e parë të Lëviz Albania me titull projekti : Monitorimi dhe përmirësimi i performancës së Bashkisë Bulqizë krijimi i një database për bashkinë e Bulqizës. Studimi i teknikave të nevojshme për krijimin e arkitekturës e cila do të mbështetet në teknologjinë e nevojshme për mbarëvatjtjen e aktiviteteve në mënyrë sa më efiçente dhe të sigurte trajnimit të stafit si dhe përshtatshmerise së tyre me legjislacionin ne fuqi.

Krijimin i nje sistemi menaxhimi Bazash të Dhënash për të siguruar mirëfunksionimin e aktiviteteve brenda Bashkisë Bulqizë si edhe raportet me palët e treta (outsourcing)

“Instituti për kërkim dhe zhvillim Wisdom” ka aplikuar në Erasmus + me EBY: Empowering Balkan Youth, si partner e “International Center for Southern Europe” ku fokusi është rritja e kapaciteteve të të rinjve për të marrë iniciativa të rëndësishme në aspektin social, kulturor dhe ekonomik. Të treja këto aspekte luajnë rol të rëndësishëm kur promovohen në një fazë të hershme tek studentët në mënyrë që të kultivojnë një kulturë dialogu, mirëkuptimi tek gjeneratat e reja. Kjo i ndihmon studentët të përvetësojnë aftësi

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	
Institucionet qeveritare bashkëpunuese:	Lloji i bashkëpunimit
Institucioni 1	Akademia e Shkencave
Institucioni 2	Universiteti i Padovas Universiteti i Terramos CILS` Qendra Ndërkombëtare për studime ligjore në Austri Universum , Kosovë MBS, College of Crete

	TBU, Tirana Business University Norman Academy dhe `The Ruggero II University`
Organizatrat Profesionale:	
Organizata 1	Instituti ndërkombëtar për të drejtën private, tregtare dhe të konkurrencës
Organizata 2	Shoqata vullnetare për zhvillim dhe solidaritet Europe Agency
Komuniteti i biznesit, tregu i punës:	
Firma 1	Kompania Coca -Cola
Firma 2	Hotel Diplomat

4.3 INFORMACION MBI KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCION APO MBI PROJEKTET QË MERR PJESË SI PALË AKTIVE (NËSE KA)

a. Politikat e kërkimit shkencor

Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “ Wisdom University ” është një Institucion i Arsimit të Lartë i orientuar drejt kërkimit shkencor. Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “ Wisdom University ” inkurajon të gjithë anëtarët e stafit akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare.

Zhvillimi dinamik i karrierës akademike e profesoratit të brendshëm, brenda strukturave të institucionit tonë është vlerësuar si një nga themelet e një perspektive të qëndrueshme. Stafi akademik është angazhuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në politikat kërkimore në funksion të rritjes akademike dhe profesionale. Në kuadër të realizimit të procesit kërkimor kjo IAL, ka ngritur dy Njësi Kërkimore/Shkencore të cilat koordinojnë punën kërkimore shkencore për fakultetet respektive të IAL-së. Është vlerësuar mundësia për mbështetjen e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore si brenda dhe jashtë vendit nga ana e pedagogëve duke përcjellë thirrje për pjesëmarrje në aktivitete shkencore në vend e më gjerë, si dhe duke i subvencionuar koston e lëvizjes së tyre, tarifat e aplikimit në këto aktivitete shkencore etj.

Kjo procedurë realizohet në përputhje me axhendën e aktiviteteve shkencore që miratohet nga Njësia Kërkimore. ShLUJ `Wisdom University` është angazhuar të mbështesë disa inisiativa për publikimin e kërkimeve shkencore nga partnerët tanë dhe të huaj. Plani i aktiviteteve shkencore parashtron politikat kërkimore dhe objektivat e matshëm kërkimorë përgjatë një viti akademik dhe ndërtohet nga propozimet e departamenteve respektive për çdo fakultet, si dhe bashkëpunon me Zyrën e Këshillimit të Karrierës. Në axhendën e Njësive Kërkimore parashikohen promovimet e vlerave botuese të kërkuesve të rinj në vend dhe jashtë tij, si dhe janë paraparë disa masa për ofrimin e ambjenteve fizike të institucionit në rast organizimesh me veprimtari shkencore. Njësia kërkimore mban kontakte me të vazhdueshme me AKTIN dhe është angazhuar të realizojë procesin e vetë vlerësimit në nivel IAL nëpërmjet mekanizmave të ofruar nga kjo agjensi.

ShLUJ `Wisdom University` ka organizuar disa aktivitete me karakter shkencor me

partnerë të ndryshëm si Qendra Ndërkombëtare për studime ligjore në Austri, Ministria e Integritit, Ministria e Turizmit, Ministria e Mjedisit, Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë, shtëpi botuese të ndryshme etj. Në kuadër të veprimtarive që u zhvilluan përgjatë viteve akademike 2012-2016, në ambjentet e ShLUJ "Wisdom University" renditen disa aktivitete të rëndësishme si psh: konferenca kombëtare shkencore me temë "Shoqëritë tregtare shqiptare përballë sfidave të integritit europian" me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të rëndësishme në vendin tonë dhe në Kosovë; zhvillimi i konferencës me temë: "Roli i Arsimit të lartë në funksion të integritit të Shqipërisë në BE", seminari i hapur me temë "Praktikat në Biznesin Gjerman, për vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim informimin e studentëve të ShLUJ mbi programin e përzgjedhjes së kandidatëve të kualifikuar prej kompanive gjermane për të ndjekur praktikat në shtetin gjerman si dhe drejt rekrutimit në frontet e punës; aktiviteti i promovimit të librit, "Jo vetëm "Hymni i Flamurit", me autor Z. Paolo Muner, hulumtues Italian për historinë e Shqipërisë dhe me pjesëmarrjen e personaliteteve si Z. Artan Lame dhe Ambasadori i Përhershëm, Z. Paolo Foresti. Ky botim dygjuhësh në gjuhën shqipe dhe gjuhën italiane u sponsorizua nga Shluj "Wisdom University". Disa leksione të hapura janë mbajtur gjatë kësaj periudhe kohore, kryesisht nga lektorë brenda IAL-së në kuadër të marrjes së gradave dhe titujve shkencorë.

Botimi i "Wisdom University", Nr. 2, 2016, e cila gëzon parametrat ndërkombëtarë duke përmendur bordin editorial, i cili përbëhet nga profesorë të disa fushave studimore, si drejtësi, ekonomik, shkenca sociale dhe të gjuhës së huaj, etj. Në këtë botim publikohen artikuj shkencorë të pedagogëve efektivë dhe jo efektivë të ShLUJ "Wisdom University". Promovimi i tyre realizohet nga Njësia Kërkimore, e cila parashikon të përcaktojë koston e botimit dhe organizimin e ceremonisë së prezantimit. Roli studentor në aktivitetet shkencore ka qenë parësor dhe përfshirja e tyre në aktivitetet me këtë karakter është paraparë në axhendën e Njësies Kërkimore.

b. Informacion mbi ndërlidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Duke patur parasysh ndërlihdjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, në programet e ciklit të dytë, studentët janë nxitur vazhdimisht të ndërmarrin kërkime të cilat kanë rezultuar në botimin e artikujve dhe në pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme.

Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Instalimi i kontakteve me institucione akademike homologe të huaja është vlerësuar si një nga parametrat të cilat duhet të jenë gjithmonë në nivele të qëndrueshme. ShLUJ `Wisdom University` bashkëpunon ngushtë edhe me institucione të tjera të arsimit të lartë në Europë dhe me Bashkimin Europian në kuadër të programeve Tempus, Jean Monnet, Erasmus+ si dhe me institucioneve të tjera në kuadër të programeve mbështetëse për kërkimin nga donatorë ndërkombëtar dhe lokalë. Ndërkohë që institucioni është vizituar nga lektorë dhe personalitete të huaja, të cilët kanë sjellë eksperiencën në mjediset akademike shqiptare. Kjo IAL vizitohet nga lektorë të huaj në mënyrë periodike në kuadër të marrëveshjes me Qendrën ndërkombëtare për studime ligjore në Austri.

Në fazën në të cilën është futur institucioni ynë janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me karakter akademik dhe praktik. Lidhjet me komunitetin janë të forta në drejtimin e krijimit të urave të bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm, si organizata profesionale dhe shoqata jofitimprurëse. Aktualisht regjistrohen 12 marrëveshje bashkëpunimi, binjakëzime dhe memorandume mirëkuptimi në nivel institucional, me shkolla të larta universitare, akademi, agjensi punësimi, organizata jofitimprurëse dhe shoqata të ndryshme.

ShLUJ `Wisdom University`, në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit akademik në nivel ndërkombëtar si edhe mobilitetit të studentëve drejt programeve të ngjajshme, ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Institucionin e Arsimit të Lartë, MBS College of Greece, i cili është filial i Staffordshire University në Britaninë e Madhe. Marrëveshja e nënshkruar në vitin 2015, ka si qëllim kryesor mobilitetin e studentëve të ShLUJ `Wisdom University` drejt `MBS College of Greece` në programet e studimit në Drejtësi, Ekonomik dhe Psikologji. Mobiliteti i studentëve realizohet në kuadër të njohjes së programeve të studimit në ShLUJ `Wisdom University` nga MBS College of Greece dhe sipas sistemit të transferimit të

krediteve, ECTS, European Credit Transfer System. Po ashtu, kjo marrëveshje parashikon aktivitete akademike dhe shkencore të përbashkëta në nivel institucional, duke përfshirë këtu shkëmbimin e eksperiencës në mësimdhënie për lektorët e dy IAL-ve; organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta dhe publikimin e produkteve shkencore.

ShLUIJ `Wisdom University` garanton cilësinë dhe ligjshmërinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe është në kërkim të bashkëpunimeve të reja që kontribuojnë në rritjen akademike të institucionit dhe zhvillimin e profesionalizmit të stafit pedagogjik sipas standarteve perëndimore universitare. Marrëveshja më e fundit, është realizuar si një formë e binjakëzimit mes ShLUIJ `Wisdom University` , Norman Academy dhe The Ruggero II University.

6. FUSHATA E MARKETINGUT

Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “ Wisdom University “ ka si qëllim të promovojë një imazh sa më pozitiv të institucionit dhe të njohë publikun me misionin dhe objektivat që synon të arrijë ky institucion.

Janë përdorur kanalet e komunikimit me synim që grupeve të interesuara tu përcillet mesazhi promociional. Materialet promovuese si broshura, katalogë, përmbajnë informacion në lidhje me Programin e studimit, kushtet e pranimit dhe kushtet e mbështetjes për kandidatët që kanë arritur rezultate të larta në provimet e Maturës Shtetërore.

Informacionet e përdorura në fushatat e marketingut kanë qenë të sakta, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe janë miratuar nga titullarët e institucionit.

Politika e Promovimit

Sigurimi i promovimit të Shkollës së Lartë Universitare “ Wisdom University “ tek nxënësit e Shkollave të mesme në të gjithë Shqipërinë;

- *Informimi i nxënësve maturantë në shkollat vendase, në lidhje me programet e studimit dhe kushtet që ofron Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University “*
- *Promovimi i imazhit të institucionit, nëpërmjet reklamimit në media të ndryshme dhe shpërndarja e broshurave ;*
- *Përdorimi i mediave të reja, siç janë rrjetet sociale që ofron internet për të informuar kandidatët potenciale për studentët dhe në përgjithësi targetin e institucionit;*

7. VLERËSIME TË INSTITUCIONIT MBI MAS DHE REKOMANDIME

1. Vlerësim i përgjithshëm i komunikimit me MAS dhe APAAL

SHLUJ “Wisdom University” shpreh vlerësimin maksimal për marrëdhëniet dhe komunikimin të mirë që ka pasur me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Komunikimi ka qënë mjaft korrekt me drejtuesit dhe stafin e MAS. Gjatë këtij viti SHLUJ “Wisdom University ” iu nënshtrua procesit të akreditimit dhe finalizoi akreditimin Institucional me kusht dhe akreditimin me kusht të programeve Master i Shkencave “E drejtë Civile dhe Tregtare” dhe Master i Shkencave “E drejtë Penale”.

Dëshirojmë të theksojmë se mbetemi të hapur për bashkëpunim të mëtejshëm. Bashkëpunimi deri më tani me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit është shumë pozitiv dhe ky bashkëpunimin mbetet shumë i rëndësishëm për Institucionin tonë.

1. Rekomandime:

Mendojmë se duhet kushtuar më shumë kujdes afateve kohore të përcaktuara në kodin e Procedurave Administrative dhe Udhëzimeve të MAS. Në lidhje me përgjigjen e kërkesave që bëjnë IAL-të, për akreditime të programeve të studimit, për hapje të programeve të reja të studimit. Ka vend që të përmirësohet bashkëpunimi me APAAL.